



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 31.10.2016

Vendim
Nr. 52, datë 31.10.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË PLANIN MËSIMOR TË PROGRAMIT
"BACHELOR NË KIMI DHE BIOLOGJI"

Mbështetur në nenin 3, pika 2, shkronja **b** dhe nenin 38, shkronja **dh** të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përmbushje të "Standardeve Shtetërore të Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë: Për Akreditimim e Programeve të Studimeve të Ciklit të Parë, (Bachelor)", Standardi V.2, Senati Akademik në mbledhjen e datës 31.10.2016

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Kimisë për integrimin e punëve të laboratorit në lëndët: KIM 143 *Kimi e përgjithshme* dhe KIM 255 *Kimi organike* si më poshtë:

- Lëndëve KIM 143 *Kimi e përgjithshme* dhe KIM 255 *Kimi organike* në programin e studimit "Bachelor në kimi dhe biologji" aktualisht me 8 kredite (ECTS) në raportin 3 leksione, 2 seminare t'u shtohet 1 (një) orë punë laboratorit dhe të bëhen 3 leksione, 2 seminare, 1 orë laboratorit me 8 kredite.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Fakulteti i Shkencave Teknike, Departamenti i Kimisë, sekretaria mësimore e fakultetit.
 3. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.